

VENDIM
Nr.728, datë 20.10.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME KONCESION
TË NDËRTIMIT DHE SHFRYTËZIMIT TË PORTIT TË JAHTVE NË SPILLE, KAVAJË,
DHE MIRATIMIN E BONUSIT NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE QË I
JEPET BASHKIMIT TË SHOQËRIVE “ÇABEJ SHPK DHE ABG, NDËRTIM SHPK”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pikat 1 e 3, dhe 23, pika 3 shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënien me koncesion të ndërtimit dhe shfrytëzimit të Portit të Jahteve në Spille, Kavajë, është Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.
2. Koncesioni të jetë i formës BOT (ndërtim, operim dhe transferim në pronësi të shtetit).
3. Miratimin e bonusit prej 6.3% të pikëve për rezultatin teknik, financiar dhe mjedisor në procedurën përzgjedhëse konkurruese (propozim i pakërkuar) që i jepet bashkimit të shoqërive “Çabej sh.p.k. dhe ABG, ndërtim sh.p.k.”.
4. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha